

SKEDË TEKNIKE

RÖFIX Unistar® LIGHT

Llaç ngjitës dhe rrafshues




Fushat e përdorimit

Llaç përforcues mineral, ngjitës i bardhë për poliestrol(EPS-F),lesh guri-(MW) shkumë e ngurtë poliuretani (PUR / PIR) dhe pllakë izoluese me fibra druri (WF), e veshur me RÖFIX IB 015 pllakë izoluese Aerogel. Për shtresë përforcuese rezistente ndaj goditjeve 5mm (trashësi minimale e suvasë MPD) Kategorja e përdorimit: I sipas ETAG 004. XL- Vonesë e mundshme. Për ngjitjen dhe përforcimin e pllakave të xokolaturës, të prera dhe të thata (EPS-P/XPS-R). Pllaka izoluese për zonën e xokolaturës, e cila është veshur me sistemin: ngjitës, llaçin përforcues dhe grafiaton, duhet të izolohet me OPTIFLEX dhe të vendoset në zonën me kontakt me tokën deri rreth 10 cm nën nivelin zero dhe + 5 cm mbi tokë. Respektoni standardet kombëtare. Forca e aftësisë lidhëse sipas ÖNORM B6400: të lëndës drusore (OSB/3): > 0,08 N/mm² mbi beton: 0,25 N/mm²

Karakteristikat

- I përdorshëm në mënyrë universale
- Rezistencë maksimale ndaj goditjeve dhe përplasjes (rezistent ndaj breshrit)
- Përpunim i shkëlqyer
- Kohë e gjatë hapjeje

Përpunimi



Të dhëna teknike

Numri i artikullit	15411
EAN	9003304154111
Paketimi	
Sasi për njësi	25 kg/Nj.
Njësi për paletë	48 Nj./Pal
Madhësia e kokrrizave	0-1,2 mm
Ngjyra	e bardhë
Konsumi	rreth. 1 kg/m ² /mm rreth. 3,5 kg/m ² (ngjitje) rreth. 5 kg/m ² (forcim)
Udhëzime për përdorimin	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit.
Konsumi i ujit	rreth. 25 L/Nj.
Njësia e kërkesës për ujë	rreth. 8,25 L/Nj.
Reaksioni ndaj zjarrit	A2-s1, d0

RÖFIX Unistar® LIGHT

Llaç ngjitës dhe rrafshues

Numri i artikullit	15411
Kapilariteti	< 0,5 kg/m ² *min0,5 ETAG 004
Difuzioni i avullit të ujit	rreth. 20
Forca në shtypje	rreth. 4 N/mm ² (28 d) EN 1015-11
Forca në përkulje	≥ 1,5 N/mm ²
Përcjellshmëria termike	0,33 W/mK për P=50% EN 1745:2002 (Vlera e tabelës) 0,36 W/mK për P=90% EN 1745:2002 (Vlera e tabelës)
Moduli-E	rreth. 3500 N/mm ²
Koha e tharjes	rreth. 7 d
Trashësia minimale e suvasë	5 mm
Rezistenca ndaj goditjes	> 10 J
Vlera sd	rreth. 0,1 m
Kapaciteti termik	rreth. 1,11 kJ/kg K
Dëndësia në gjëndje të papërpunuar	rreth. 1090 kg/m ³
Temperatura e nënshtresës	5-25 °C

Baza e materialit

- Rërë gëlqerore e thërrmuar me cilësi të lartë
- Lehtësi (organik)
- Çimento e bardhë (pa kromate)

Kushtet e punimit

Gjatë fazës së tharjes dhe përpunimit, temperatura e ambientit dhe bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C. Deri sa të arrihet tharja e plotë, mbrojeni nga ngrirja, tharja e shpejtë (rezatimi direkt i diellit, era) dhe shiu.

Bazamenti

Bazamenti duhet të jetë i thatë dhe i pastër, me aftësi mbajtëse si dhe pa papastërti si p.sh. pluhur, alga, blözë, kripra etj. .

Bazamenti-Trajtimi paraprak

Largoni lëndët ndarëse që formojnë shtresa filmi (vaj armature etj.). Sipërfaqet prej karbonat kalciumi ose rërë përforcimi me RÖFIX fiksues ose largojini fare. Në bazamentet e vjetra ose pa aftësi mbajtëse, pllakat termoizoluese fiksohen me tiplla.

Përgatitja

Në aplikimin me dorë një thes përziheni sipas raportit me ujë të pastër duke përdorur një mikser ose përzierës mekanik derisa të arrini një masë homogjene. Koha e përzierjes në rast përzierje me dorë 2 deri 3 minuta. Pas përzierjes lëreni 10 min. në qetësi dhe pastaj përziheni përsëri.

Këshilla për përpunimin

Pllakat izoluese mund t'i nënshtrohen një ngarkese mekanike të pjesshme (p.sh. goditje me një thikë, lëmues ose mbështjellës) pasi ngjitësi të jetë ngurtësuar

RÖFIX Unistar® LIGHT

Llaç ngjitës dhe rrafshues

mjaftueshëm. Ky maturim arrihet pas përafërsisht 2 ditësh në një temperaturë minimale rreth +15 °C (edhe në nënshtresa me absorbim të dobët si betoni). Komponentët më të ftohtë në temperaturë deri në +5 °C dhe nën +15 °C, kur lidhen e vonojnë shpejtësinë e ngurtësimit me të paktën 1-2 ditë, edhe në kushte moti të këndshëm e të ngrohtë gjatë ditës. Materialin i hapur më parë nuk duhet përdorur, gjithashtu mos e përzieni me materialin e ri. Përpunoni dhe përdorni llaçin e freskët brenda 2 orëve.

Përpunimi

Ngjitja e pllakave të termoizolimit: Shtrojeni llaçin ngjitës me metodën me pika - shirita (rreth 40% sipërfaqe ngjitjeje) gjerësia e shiritave rreth 5 cm, lartësia rreth 2 cm.

Në rastin e bazamenteve të ulta dhe pllakave termoizoluese me lesh xhami të veshura vetëm nga njëra anë, ngjitësi mund të aplikohet me një mistri të dhëmbëzuar në pjesën e prapme të pllakave termoizoluese.

Rrafshimi pllakave termoizoluese: Llaçin armues aplikojeni rreth 2-3 ditë pas ngjitjes (sipas motit dhe vendosjes së tipllave) me trashësi minimale 5mm dhe kriheni me shpatullën e dhëmbëzuar R16.

Rrjeta përforcuese aplikohet brënda në shtratin e llaçit, mbivendoseni në zonën e bashkimit minimalisht 10 cm dhe rrafshojeni me mistri. Nëse është e nevojshme nivelojeni me mastar.

Pas një kohe prehje prej 5-7 ditësh (sipas kushteve atmosferike - në kohë të ftohtë dhe me lageshtirë të gjatë) mund të aplikohet suvaja e sipërme e përshtatshme RÖFIX. Produkti mund të aplikohet në një trashësi prej 5 deri në 12 mm.

Pjesët kufizuese të ndërtesës (si dyer, dritare korniza dritaresh etj) përgjithësisht duhet të mbulohen para punimeve për të mënjeluar ndotjen ose korrozionin. Fugat e zgjerimit: Fugat konstruktive ose fugat ekspansive nuk duhet të mbulohen. Në zonat e jashtme nuk duhet të bëhen prerje në suva, por duhet të përdoren profile të përshtatshme suvaje. Pas qëndrimit të duhur, kohës së tharjes, në varësi të llojit të profilin të përdorur në vendndërtim, bëhet një fugim profesional. Nëse përdorni ngjyra të errëta me gradë reflektimi nga <25% HBW mbi sistemin e termoizolimit, duhet të keni parasysh rregulloren RÖFIX Syco- Tec.

Magazinimi

Magazinojeni në vende të thata mundësisht mbi paleta druri. Koha e magazinimit: min. 12 muaj sipas. Rregullores 1907/2006/EG, Aneksi XVII, në temperaturë +20 °C, 65 % lagështi ambjenti.

Certifikatë



Udhëzime teknike dhe ligjore

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skedat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

Këshilla të përgjithshme

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkrijnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në veteve nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet RÖFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohej një cilësi e pandryshueshme. Staf i ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit (www.roefix.com), ose mund të kërkojnë edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Të gjitha të dhënat teknike të dhëna në këtë fletë produkti janë përcaktuar në kushte laboratorike.